

PROGRESI NË TRANZICIONIN E
EUROPËS LINDORE : IMPLIKIMET PËR
SHQIPËRINË

Riccardo Lago
BERZH

Në prezantimin tim jam mbështetur në raportet e tranzicionit të publikuara nga BERZH, ku jepet një tablo e zhvillimeve ekonomike të 27 vendeve, në të cilat BERZH investon. Shqipëria është një nga këto 27 vende.

Raportet tona të tranzicionit të vitit 2001 tërheqin vëmendjen mbi problemet e energjisë, përdorimin e energjisë dhe burimet e energjisë në vendet e Europës Qendrore dhe në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik. Për më tepër, si dhe një vit më parë, ne japim një tablo të zhvillimeve makroekonomike dhe të progresit në vendet në tranzicion. Ne, gjithashtu, japim një përshkrim nga vendi në vend, i cili është një burim i frytshëm informacioni për rajonin.

Raportet e tranzicionit të këtij viti na përcjellin tre mesazhe kryesore. Mesazhi i parë është se në krahasim me tregjet e tjera

emergjente, vendet në tranzicion do të jenë relativisht pika ndriçuese në një mjedis të errët ekonomik. Edhe pse vendet e Europës Juglindore dhe vendet e ish-Bashkimit Sovjetik janë të influencuara nga rënia e përgjithshme e ekonomisë botërore, efektet janë shprehur më pak se në vendet e Amerikës Latine, të Azisë, të Afrikës dhe në tregje të tjera emergjente.

Mesazhi i dytë i raporteve është që disa vende në rajone të tjera, veçanërisht në Rusi dhe në Detin Kaspik, kanë potenciale dhe burime enegjitike shumë të mëdha, por reforma sektoriale dhe një administrimin ekonomik i kujdesshëm janë të nevojshme për këto burime, që të përdoren sa më mirë për zhvillimin e këtyre vendeve.

Mesazhi i tretë është që në vendet në tranzicion, ndoshta dhe si pasojë e trashëgimisë nga vitet e planifikimit të centralizuar, intensiteti i energjisë për njësi të prodhimit është i lartë dhe përdorimi i energjisë nuk është efikas. Kështu që, mesazhi ynë nënvizon rëndësinë e:

- a) politikës së çmimit dhe grumbullimit në sektorin e energjisë; dhe
- b) politikave eficiente në furnizimin me energji.

Indeksi i progresit në tranzicion, i parë në këndvështrime të ndryshme, si liberalizimi, privatizimi i të gjitha niveleve, i 27 vendeve, në të cilat vepron BERZH, përfshin periudhën nga viti 1989 deri më sot.

Ne mund të themi që këtu ka patur progres si në liberalizim ashtu edhe në privatizimin e niveleve të mëdha dhe të vogla, vit pas viti.

Ne marrim rritjen e treguesit të tranzicionit dhe e analizojmë rast pas rasti secilin vend, rezultatet e arritura të secilit vend dhe shohim vendet që kanë bërë më shumë përparime duke iu referuar rritjes. Progresin më të mirë e ka Jugosllavia, për shkak të ndryshimit të regjimit dhe nismave të reformave të drejtuara nga tregu dhe më pak progres ka shënuar Turkmenistan. Shqipëria renditet pak më poshtë se mesatarja në ngjashmëri me ritmin e rritjes së Polonisë dhe Estonisë.

Në performancën e rritjes, ne kemi një fenomen interesant. Sa shumë ka ndikuar aktiviteti ekonomik i Bashkimit European në rritjen si të eksportit ashtu dhe të importit? Vendet e Europës Qendrore patën një rritje të eksporteve që varionte nga 30 deri në

40 për qind gjatë vitit 2000 dhe kjo shifër ka rënë në nivelin e 10 përqindshit nga maji i vitit 2001 deri më sot. Kjo ka në mënyrë të dukshme efekte të tjera në rritjen e PBB-së.

Progresi në tranzicion dhe stabiliteti në vende të ndryshme, në të cilat ne veprojmë, ka ardhur hap pas hapi me më shumë investime direkte të huaja në ato vende, të cilat kanë përparuar më shumë në rregullimet strukturore dhe në stabilitet. Europa Qendrore dhe Baltiku, të ashtuquajturat tetë nga dhjetë vendet që janë në procesin e pranimit në Bashkimin Europian, kanë thithur pothuajse 250 dollarë të investimeve të huaja e matur për frymë, duke u rritur nga viti në vit.

Vendet e CIS dhe të Europës Juglindore janë relativisht më mbrapa. Në Shqipëri ne kemi vërejtur një rritje të konsiderueshme të investimeve të huaja për frymë gjatë viteve 2000-2001 dhe kjo ka ardhur e shoqëruar me procesin e forcimit të stabilitetit ekonomik, me një rritje më të shpejtë mbas krizës së vitit 1997 dhe sigurisht me përmasat e privatizimit.

Çfarë parashikojmë ne për rritjen e rajonit? Autoritetet ndërkombëtare, OSCD së fundi kanë rishikuar përkeqësimet me rreth 1 për qind të rritjes të vendeve anëtare të OSCD. Në vitin 2001, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka rishikuar dy herë parashikimin e perspektivës së ekonomisë botërore dhe tani ata janë duke parashikuar rritje të ulët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Europë, gjithashtu, si dhe një ngadalësim të ritmit të rritjes së ekonomisë botërore me rreth 1 dhe 2 për qind. Është kënaqësi të them që rajoni po paraqitet i fuqishëm dhe këtë vit ne parashikojmë një rritje prej 4.3 për qind për rajonin. Kjo shifër është mesatarja e rritjeve shumë të shpejta prej 6.7 për qind të vendeve të CIS, duke përjashtuar Rusinë (5.5 për qind), 4 për qind për vendet e Europës Juglindore, ku përfshihet edhe Shqipëria, dhe 2.9 për qind për vendet qendrore të Europës Lindore dhe Vendet Baltike.

Për vitin 2002, ne parashikojmë një rritje prej 3 dhe 3.5 për qind, e cila vazhdon të jetë një performancë e mirë në një ambjent ekonomik shumë të përkeqësuar. Shqipëria, e cila pas krizës së vitit 1997 ka patur një normë rritjeje prej +7 për qind, do të rritet me 6 për qind për aq kohë sa do të ruhet procesi i privatizimit, për aq kohë sa do të ketë progres në reformat rregullatore, në reformat e klimës së bizneseve dhe rritje të stabilitetit makroekonomik. Këto janë supozimet që mbështesin këtë 6 për qind rritje.

Kjo rritje e rajonit ka qenë në kontekst me reduktimin e inflacionit; mesatarja e inflacionit për rajonin është 15 për qind dhe parashikohet që, në qoftë se politikat vazhdojnë në të njëjtin drejtim që ato ndoqën këtë vit, kjo do të reduktohet në 11 për qind përgjatë vitit 2002 dhe do të shkojë drejt inflacionit njëshifror. Tashmë inflacioni njëshifror ekziston në vendet qendrore të Europës Lindore dhe në Baltik në një mesatare prej 4 deri në 4,5 për qind.

Në raportet e tranzicionit, gjatë analizimit të problemit të energjisë, gjithashtu, i kushtohet vëmendje dhe prodhuesve të energjisë në rajon, të cilët janë Rusia dhe vendet Kaspike si dhe disa vende të Azisë Qendrore. Duket që burimet e energjisë për rajonin janë me të vërtetë domethënëse, për shembull, Rusia ka 33 për qind të rezervave të gazit në botë, ndërsa si prodhim ajo zë vetëm 21 për qind dhe vendet Kaspike kanë 2 për qind të rezervave të naftës si dhe 2 për qind të prodhimit. Në Rusi, burimet janë madhështore dhe Gasprom, i cili është prodhuesi më i madh i gazit në Rusi, ka 1/3 e rezervave të botës. Gjithësesi, po të shohim kapitalizimin e tregut për metër kub dhe çmimin e aksionit të Gasprom dhe ta krahasojmë atë me kapitalin e një aksioni për metër kub të Exxonmobil, vihet re që Exxonmobil ka një kapitalizim tregu për metër kub të gazit 100 herë më të lartë se Gasprom. Kjo ka lidhje me faktin se ka pasiguri në të drejtat e *cash flow* të Gasprom edhe kur ndarjet kryhen në prani të aksionerëve, kryesisht për shkak të regjimit diktatorial dhe të izoluar në Rusi. Zvogëlimi i të drejtave të pronësisë së aksionereve të vegjël, mbështet kapitalizimin e ulët të tregut për Gasprom-in. Megjithatë, në qoftë se reformat në Rusi vazhdojnë, priten përmirësime në këtë drejtim.

Është interesante të shikosh se në çfarë shtrirjeje burimet natyrore ndihmojnë ose pengojnë reformat dhe rregullimet. Është vënë re se vendet qendrore të Europës Lindore dhe vendet e Europës Juglindore, të cilat nuk kanë shumë burime natyrore si naftë, gaz, miniera dhe të tjera kanë përparuar më shumë me reformat se sa vendet e pasura të CIS, si Uzbekistan, Kazakistan, Rusia etj.. Arsyeja për këtë është se, në njëfarë mënyre rezervat e shumta të burimeve natyrore mund t'i detyrojnë vendet drejt një niveli të caktuar jetese dhe të bëhen zëvendësues për reformën. Vendet, të cilat nuk i kanë këto burime, i përkushtohen më shumë reformave strukturore, në një stabilizim që mund të jetë zëvendësuese e tyre.

Një shembull i qartë ndërkombëtar i kësaj situatë është krahasimi i performancës së Nigerisë ose Venezuelës, të dyja vende shumë të pasura me energji, me Korenë Jugore, e cila nuk ka burime natyrore. Kjo do të thotë se stabiliteti makroekonomik, reformat

strukture dhe puna e banorëve dhe e organizatave, të cilat kanë zëvendësuar këto burime natyrore, ndikuan në një rritje të shpejtë në Kore dhe në një performancë ekonomike të zyrtë në Nigeri dhe Venezuelë. Kjo gjë mund të duket mjaft qartë edhe në vendet e rajonit. Intensiteti i energjisë për njësi të PBB-së vazhdon të jetë një problem në vendet në tranzicion. Përgjatë viteve të planifikimit të centralizuar, që nga shpërndarja e procesit të përvetësimit dhe të prodhimit, edhe pse ndiqej një diktat politik më shumë se sa një racionalizim ekonomik, energjia nuk ishte përdorur në mënyrë eficiente. Përdorimi i energjisë ishte me humbje të mëdha dhe intensiteti i energjisë ishte shumë i lartë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për 1000 dollarë të PBB energjia e përdorur ishte më e ulët se 0.5, ndërsa në Europën Qendrore dhe Juglindore përdorimi i energjisë mund të ishte më i lartë se 2. Në Shqipëri kjo është 0.75. Në vendet CIS, intensiteti i energjisë është rreth 4, që do të thotë se është 8-9 herë më i lartë se në Amerikë. Kjo tregon qartë se strukturat industrialiste në rajon nuk janë përfshirë plotësisht dhe nuk kanë ndikuar plotësisht në çmimin dhe në koston oportune të energjisë. Kjo, gjithashtu, tregon se rruga që ne po udhëheqim do të jetë ekonomizimi i përdorimit të energjisë dhe faktori kyç do të jetë politika e çmimit në sektorin e energjisë duke përfshirë elektricitetin, gazin, naftën si dhe gjithashtu politika mbështetëse e strukturës industriale.

Në Europën Qendrore Lindore dhe në Baltik ka qenë një tendencë drejt një përdorimi më racional dhe një intensiteti më të ulët të përdorimit të energjisë. Kjo nuk ka ndodhur kështu në Europën Juglindore. Industria ka vazhduar të përdorë me intensitet energjinë dhe kjo ka qenë situata dhe për vendet e CIS. Çfarë rëndësie ka kjo tendencë drejt përdorimit racional dhe ekonomik të energjisë?

Pikë së pari kjo ka lidhje me reformat e tarifës. Në sistemet socialiste të planifikimit të centralizuar, elektriciteti është përdorur si një mall i prekshëm nga individët, nga sektori rezidencial, por edhe nga ndërmarrjet. Gjithësesi, kjo nuk duhet të ishte kështu. Elektriciteti është një mall ekonomik, i cili ka një kosto oportune të lartë dhe duhet të përdoret me efikasitet. Reformat e tarifës dhe përforcimi i pagesave të energjisë elektrike dhe i formave të tjera të energjisë duhet të jenë një prioritet kyç. Megjithatë, nëpërmjet procesit të tranzicionit, shumë vende kanë të ardhura shumë të ulta dhe përpara se të vendosin çmimin e arsyeshëm të koston së energjisë tek individët (ekonomitë shtëpiake) dhe ndërmarrjet, duhet të mendohen objektiva subvencionit për shtresat e varfëra të shoqërisë.

Problemi i dytë është që është e rëndësishme të liberalizohet sektori privat bazë për nxitje të reja dhe efikase. Në rastin e Shqipërisë, privatizimi sa më i shpejtë i KESH duhet të jetë një nga kërkesat e para të biznesit. E njëjta gjë është e vërtetë dhe për kompaninë e naftës, e cila është shpërbërë dhe me aq sa unë di, është në procesin e privatizimit. Gjithashtu, është e rëndësishme që të lehtësohet hyrja e sektorit privat në rregullimet e parashikueshme dhe të forta, në mënyrë që të mund të matet rreziku me saktësi si dhe të shpërndahet.

Një problem tjetër është ai i aftësisë paguese. Disa vende si Gjeorgjia dhe Armenia etj. kanë çmime aktuale. Në Gjeorgji, nëse njerzit do të paguanin koston e plotë të energjisë dhe të gjithë dobishmërinë, pjesa e të ardhurave të tyre që mund të harxhohet për përdorimin e energjisë dhe dobishmërinë do të jetë 12 për qind e çmimit aktual. Nëse tarifat do të reflektonin koston e plotë, koston marxhinale të ulët, kjo pjesë do të ishte 16 për qind. Kështu që, nuk është e arsyeshme që të supozojmë se shtresat e varfëra të shoqërisë do të jenë në gjendje të përballojnë çmimin, nëse do të kishim një lëvizje nga tarifat aktuale në tarifat me çmimin e koston së plotë. Prandaj, është e rëndësishme të kemi objektiva subvencionit për këtë grup. Në raportet, ne propozojmë përdorimin e tarifave sipas "nivelet të jetesës", në kuptimin që shtresave të varfëra të popullsisë iu është shpërndarë një sasi e dhënë e KW në orë, për javë ose për muaj, por çdo shtesë mbi këtë duhet të paguhet me kosto të plotë.

Si duhet të reagojnë vendet ndaj reformave të sektorit të energjisë, në veçanti të sektorit të energjisë elektrike? Është shumë e vështirë të bësh propozime mbasi kemi parë krizën energjitike në Kaliforni. Në janar të këtij viti, tregu ekonomik më i zhvilluar i botës dhe shteti më i pasur i atij vendi, Kalifornia, kaloi një krizë shumë serioze në procesin e liberalizimit dhe të rregullimeve. Ata ruajtën kontrollin mbi çmimet e energjisë elektrike për përdoruesit dhe liberalizuan çmimet e prodhuesve. Megjithatë, kishte probleme, dhe i gjithë sistemi shkoi drejt krizës. Kalifornia përjetoi një suficit të energjisë elektrike dhe për këtë disa kompani shkuan në falimentim. Është e rëndësishme të vepohet mirë, si dhe është e rëndësishme që pasojat të jenë të mira.

Çfarë rruge duhet të ndiqet në vendet në tranzicion? Rruga që duhet të ndiqet është shpërbërja, ndarja e prodhimit nga transmetimi dhe shpërndarja. Prodhuesit duhet të ofrohen në mënyrë konkurrionale, ndërsa shpërndarja të bëhet me

koncension. Transmetimi ka një të mirë, të ashtuquajturën natyrë e “mallit publik”, që do të thotë se disa kablllo transmetimi mund të shtohen dhe pronari mund të jetë shtetëror ose privat, por të jetë i rregulluar mirë.

Modeli që paraqesim ne është që të fillojë me privatizimin e shpërndarësit kështu që, pjesëmarrësit privatë në shpërndarje të kenë forcuar tashmë regjimin e tyre, të kenë mbledhur paratë e gjeneruara dhe të mund të paguajnë kompaninë transmetuese, ndërsa kompania transmetuese të mund të paguajë prodhuesin dhe kjo krijon një treg të elektricitetit. Ne e konsiderojmë Gjeorgjinë dhe Moldavinë si vende modele, meqenëse ato kanë pak përparësi, që kur BERZH ka investuar me investitorë ndërkombëtarë strategjikë në privatizimin e shpërndarjes. Në Gjeorgji, mbledhja e taksave e faturave totale përpara privatizimit ishte 8 për qind dhe arriti në 14 për qind që në vitin e parë pas privatizimit.

Në rastin e Moldavisë, që është dhe më i fundit, niveli u rrit nga 23 për qind në 58 për qind. Mbasi kemi bërë privatizimin e shpërndarësit, këto vende do të jenë në gjendje të privatizojnë prodhuesin sepse paratë filluan të gjenerohen në sistem. Ne mendojmë se ky është një model që mund të praktikohet dhe në Shqipëri shumë mirë. Ne jemi duke mbështetur kompaninë shtetërore të elektrikut, KESH, nëpërmjet rehabilitimit të huave të saj dhe ne presim që të ndërmerren veprime drejt shpërbërjes dhe më pas të fillohet me privatizimin e shpërndarjes në të ardhmen e afërt.

Në përfundim, do të doja të nënvizoja dy çështje të rëndësishme. Së pari, është që në një mjedis ekonomik të përkeqësuar, presim që vendet në tranzicion të kenë performancë më të lartë se tregjet e tjera emergjente dhe në qoftë se në Shqipëri vazhdojnë politikat e duhura, ne presim një rritje relativisht të mirë për vitin e ardhshëm (ne parashikojmë 6 për qind).

Së dyti, është që përdorimi i energjisë në të gjithë rajonin vazhdon të jetë me intensitet të lartë dhe me humbje të mëdha dhe ristrukturimi i industrisë duhet të merret parasysh në këtë drejtim. Që të ndodhë kjo, është shumë e rëndësishme që tendenca e tarifave të jetë drejt reflektimit të kostos së plotë dhe pagesat për sektorin e energjisë të jenë plotësisht të mbështetura.